

Në bazë të nenit 13 paragrafit 1 të Ligjit për Qendrën Shtetërore të Provimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 142/08, 148/09, 41/14, 55/16, 142/16 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" 59/25) dhe nenit 5 paragrafit 1 Rregullores për mënyrën, procedurën dhe kriteret e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm të Qendrës Shtetërore të Provimeve, nr.01-440/3, datë 28.12.2022, nr. 01-176/3 datë 1.3.2023, nr. 01-197/3 datë 15.04.2024, nr. 01-109/3 datë 11.02.2025 dhe nr.01-157/4 të datës 25.3.2025, njofton Qendra Shtetërore e Provimeve Shkup shpall

KONKURS PUBLIK

për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm – anëtarë të grupit lëndor punues për testimin shtetëror

I. Qendra Shtetërore e Provimeve Shkup shpall konkurs publik për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm - anëtarë të grupit lëndor të punës për zbatimin e testimit shtetëror në lëndën:

1. Gjuhë Shqipe – 4 (katër) anëtarë nga radhët e mësimdhënësve të praktikës të cilët në shkollat fillore e realizojnë mësimdhënien e grupit klasor në gjuhën shqipe.

II. Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të kenë të përfunduar të paktën studime akademike të ciklit të parë në fushën përkatëse;
- të jenë nga radhët e individëve profesional - mësimdhënësve të lëndës përkatëse në shkollat fillore në RMV dhe
- të kenë të paktën 3 (tre) vjet përvojë në mësimdhënie.

III. Kandidatët detyrimisht e dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- fletëparaqitja e plotësuar i aplikimit (formulari i aplikimit është i postuar në faqen e internetit: www.dic.edu.mk);
- certifikatën e shtetësisë;
- kopjen e certifikatës/diplomës për studime të kryera akademike të ciklit të parë në fushën përkatëse, e vërtetuar në noter;
- vërtetim se janë nga radhët e individëve profesional-mësimdhënës të lëndës përkatëse në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut në gjuhën mësimore shqipe dhe
- vërtetim për të paktën 3 (tre) vjet përvojë në mësimdhënie.

IV. Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm bëhet në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar me Rregulloren për mënyrën, procedurën dhe kriteret e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm të Qendrës Shtetërore të Provimeve.

V. Kandidatët që do të përzgjidhen do të angazhohen për një periudhë 3 (tre) vjeçare, duke filluar nga data e lidhjes së kontratave të angazhimit.

VI. Afati për aplikim për kandidatët e interesuar është deri më 11.4.2025.

VII. Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm do të kryhet më së voni në afat prej 18 (tetëmbëdhjetë) ditësh pas skadimit të afatit të aplikimit.

VIII. Dokumentacioni i dërguar pas afatit, i paplotë dhe i pavlefshëm nuk do të jetë lëndë shqyrtimi.

IX. Aplikacioni me dokumentacionin e kërkuar dorëzohet në Arkivin e Qendrës Shtetërore të Provimeve (nga ora 10:00 deri në ora 14:00) ose me postë rekomande, në adresën: Qendra Shtetërore e Provimeve - Shkup rr. "Vasil Gjorgov" p.n. 1000 Shkup, me shënimin **"Për konkursin publik për bashkëpunëtorë të jashtëm – anëtarë të grupit lëndor punues për testim shtetëror"**.

X. Informacione shitesë për konkursin mund të merrni në numrin 075 258 862, çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në 14:00.

QENDRA SHTETËRORE E PROVIMEVE SHKUP